

VENDIM
Nr. 70, datë 2.2.2022

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES PËR KUSHTET PËR AKSES TË LIRË
NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN PERËNDIMOR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 19, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes për kushtet për akses të lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

MARRËVESHJE
**MBI KUSHTET PËR AKSES TË LIRË NË TREGUN E PUNËS NË BALLKANIN
PERËNDIMOR**

PREAMBULË

Ne, pjesëmarrësit e Ballkanit Perëndimor, të referuar bashkërisht si “Palët Kontraktuese” dhe individualisht si “Pala Kontraktuese”,

duke shprehur vullnetin për forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe mirëkuptimit të ndërsjellë, me synimin për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe rritjen ekonomike, investimeve dhe punësimit në Ballkanin Perëndimor;

duke pasur parasysh rëndësinë e fushës së lëvizjes së punëtorëve, me qëllim sigurimin e progresit dhe prosperitetit ekonomik;

duke pasur parasysh Deklaratën e Përbashkët të nënshkruar në Novi Sad, më 10 tetor 2019, e cila bazohet në zbatimin e katër lirive themelore të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor;

duke njohur Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor të mbajtur në Ohër, më 10 nëntor 2019;

duke pranuar Deklaratën e Përbashkët të Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Kryeministrit të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Presidentit të Republikës së Serbisë, të miratuar në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Tiranë, më 21 dhjetor 2019;

në vijim të Memorandumit të Mirëkuptimit për bashkëpunim, në lidhje me aksesin e lirë në tregun e punës në Ballkanin Perëndimor, të nënshkruar në Shkup, më 29 korrik 2021;

duke theksuar se asnjë dispozitë e kësaj Marrëveshjeje nuk mund të interpretohet se i përjashton Palët Kontraktuese nga të drejtat dhe detyrimet e tyre përkatëse, sipas traktateve ekzistuese, duke përfshirë marrëveshjet e tyre ekzistuese rajonale dhe dypalëshe tregtare;

duke ftuar pjesëmarrësit e tjerë të Ballkanit Perëndimor që t'i bashkohen kësaj marrëveshjeje në frymën e gjithëpërfshirjes, bashkëpunimit rajonal dhe me synimin për të përmirësuar jetën e të gjithëve brenda rajonit,

biem dakord si më poshtë:

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Shtetasit e Palëve Kontraktuese për të cilët zbatohet kjo Marrëveshje, do të kenë të drejtën të lëvizin, qëndrojnë dhe punojnë lirisht brenda territorit të Palëve Kontraktuese, në përputhje me këtë Marrëveshje.

PËRKUFIZIME

Neni 2

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje, termat e mëposhtëm do të kenë kuptimin:

1. “Shtetas” – personi që ka shtetësinë e njërës prej Palëve Kontraktuese;
2. “Legjislacioni i brendshëm” – ligjet dhe aktet e tjera normative që janë në fuqi në njëren nga Palët Kontraktuese;
3. “Palë Marrëse – Pala Kontraktuese në territorin e së cilës ka hyrë, banon dhe punon shtetasi i Palës tjetër Kontraktuese;
4. “Numër ID-je i Ballkanit të Hapur” – numër unik regjistrimi për shtetasit, Palët Kontraktuese, të krijuara nga Pala e shtetësisë së tyre, në përputhje me Marrëveshjen për ndërlihdjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

HYRJA, LËVIZJA, QËNDRIMI DHE PUNA

Neni 3

Palët Kontraktuese marrin përsipër të thjeshtojnë procedurat administrative për hyrjen, lëvizjen, qëndrimin dhe punën e shtetasve të Palëve të tjera Kontraktuese.

Palët Kontraktuese garantojnë që shtetasit e Palëve të tjera Kontraktuese të kenë akses të barabartë në tregun e punës të Palës Marrëse, në përputhje me këtë Marrëveshje dhe legjislacionin e brendshëm.

Neni 4

Një shtetas i njërës prej Palëve Kontraktuese, përveç të drejtave të parashikuara nga legjislacioni vendës për punën e të huajve, do të ketë të drejtën e hyrjes dhe qëndrimit për qëllime pune në Palën Marrëse në përputhje me këtë Marrëveshje, me kusht që:

1. Ai/ajo të ketë kartë identiteti të vlefshme ose dokument udhëtimi biometrik, të vlefshëm për të paktën 90 ditë deri në datën e skadimit.
2. Ai/ajo nuk është ndaluar për hyrje dhe qëndrim në territorin e Palës tjetër Kontraktuese.
3. Ai/ajo nuk përbën kërcënim për rendin publik, sigurinë kombëtare, shëndetin publik ose marrëdhëniet ndërkombëtare të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 5

Një shtetasi të njërës Palë Kontraktuese që nuk plotëson kërkesat e nenit 4 të kësaj Marrëveshjeje do t'i mohohet akses i lirë në tregun e punës të Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të Palës Marrëse.

Neni 6

Një shtetas i një Pale Kontraktuese do të respektojë legjislacionin e brendshëm të Palës Marrëse kur hyn, qëndron dhe punon në territorin e Palës Marrëse.

Secila Palë Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e saj të brendshëm, i rezervon të drejtën të revokojë qëndrimin në territorin e saj, një shtetasi të Palës tjetër Kontraktuese.

Neni 7

Për të ushtruar të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës, një shtetas i një Pale Kontraktuese do të regjistrojë të dhëna personale dhe të dhëna të tjera, siç kërkohet nga shërbimi i duhur elektronik *online* i zhvilluar nga secila Palë Kontraktuese në përputhje me legjislacionin vendës dhe Marrëveshjen për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor.

Regjistrimi i përmendur në paragrafin 1 të këtij neni mund të kryhet para hyrjes në territorin e Palës Marrëse, ose pas hyrjes, por jo më vonë se 90 ditë nga hyrja në territorin e Palës Marrëse.

Një shtetas i një Pale Kontraktuese, që disponon një numër ID-je të Ballkanit të Hapur, do të konsiderohet se është regjistruar për akses të lirë në tregun e punës në territorin e Palës Marrëse, pasi të jetë njoftuar në mënyrë elektronike, se procedura e aplikimit ka përfunduar dhe se aksesit i lirë në tregun e punës është miratuar, i cili i jep të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës.

Miratimi i përmendur në paragrafin 3 të këtij neni do t'i lejojë një shtetasi të një Pale Kontraktuese të qëndrojë në territorin e Palës Marrëse deri në 2 (dy) vjet, me mundësinë e reregjistrimit, me kusht që kushtet e përcaktuara në nenet 4 dhe 6 të kësaj Marrëveshjeje të jenë përmbushur.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës siguron ushtrimin e së drejtës për punësim, pa pasur nevojë të marrë një leje pune dhe qëndrimi në Palën Marrëse, duke përfshirë përjashtimin e tarifave të aplikimit, sipas legjislacionit vendës.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës në Palën Marrëse përjashton të drejtën për stimuj shtetërorë të punësimit, përveç rasteve kur është rënë dakord ndryshe nga Palët Kontraktuese.

Nëse një shtetas i një Pale Kontraktuese të cilit i është miratuar aksesit i lirë në tregun e punës në Palën Marrëse, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, ndryshon ndonjë nga të dhënat e regjistruara përmes shërbimit elektronik *online* të Palës Marrëse, ai/ajo do ta raportojë këtë informacion pa vonesë nëpërmjet atij shërbimi elektronik *online*.

Neni 8

Në rast se aplikimi për akses të lirë në tregun e punës nuk është miratuar, do të zbatohet legjislacioni i brendshëm i Palës Marrëse, për të cilin aplikanti do të njoftohet në mënyrë elektronike.

Miratimi për akses të lirë në tregun e punës pushon së qeni i vlefshëm, nëse qëndrimi në territorin e Palës Marrëse të një shtetasi të një Pale Kontraktuese, në përputhje me legjislacionin e brendshëm, anulohet më pas, në rast se më pas zbulohet se miratimi për akses të lirë në tregun e punës është lëshuar në bazë të informacionit të rremë ose në fshehje të informacionit për qëllimin dhe rrethanat aktuale të punësimit, ose nëse arsyet për të cilat është dhënë miratimi për akses të lirë në tregun e punës, kanë pushuar së ekzistuari.

Neni 9

Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do të zbatohen, në lidhje me përmbushjen e kërkesave për aplikimin për qëndrim të përhershëm në Palën Marrëse.

Një shtetas i Palës Kontraktuese, që synon të aplikojë për qëndrim të përhershëm në Palën Marrëse, do të jetë i detyruar të veprojë, në përputhje me legjislacionin e brendshëm të asaj Pale Marrëse.

Neni 10

Dispozitat e kësaj marrëveshjeje nuk zbatohen për shtetasit që hyjnë ose qëndrojnë në territorin e Palës tjetër Kontraktuese, për qëllime turizmi ose qëllime të tjera që nuk lidhen me aksesin e lirë në tregun e punës sipas kësaj Marrëveshjeje.

Megjithatë, shtetasit e përmendur në paragrafin 1 të këtij neni nuk përjashtohen nga përdorimi i kësaj Marrëveshjeje, nëse dëshirojnë të aplikojnë për akses të lirë në tregun e punës, në përputhje me nenin 7, paragrafi 1 të kësaj Marrëveshjeje.

KOMITETI I PËRBASHKËT

Neni 11

Në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të krijohet një komitet i përbashkët i ngarkuar me organizimin, koordinimin dhe kontrollin e aktiviteteve që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 12

Komiteti i Përbashkët do të përbëhet nga të paktën pesë përfaqësues të secilës Palë Kontraktuese.

Neni 13

Komiteti i Përbashkët do të mbledhet të paktën një herë në vit dhe do t'u raportojë Palëve Kontraktuese çdo gjashtë muaj për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Komiteti i Përbashkët do të zhvillojë mbledhjen e tij të parë brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.

Komiteti i Përbashkët, në mbledhjen e tij të parë, miraton rregullat e tij të procedurës.

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 14

Palët Kontraktuese marrin përsipër të harmonizojnë legjislacionin e tyre të brendshëm me *acquis* të BE-së për çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 15

Çdo çështje që nuk rregullohet nga kjo Marrëveshje do të rregullohet nga legjislacioni i brendshëm i Palës Marrëse.

Neni 16

Palët Kontraktuese bien dakord që protokollat shtesë mund të rregullojnë më tej çështjet që lidhen me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, veçanërisht çështjet që lidhen me sistemin e informacionit që mundëson regjistrimin, si dhe çështjet që lidhen me qëndrimin, lëvizjen dhe punën e shtetasve në territorin e Palës Marrëse.

Protokollat do të lidhen nga autoritetet kompetente të Palëve Kontraktuese.

Neni 17

Çdo mosmarrëveshje që lind nga interpretimi ose zbatimi i kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet nëpërmjet negociatave.

Neni 18

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rrjedhin nga traktate të tjera ndërkombëtare në të cilat janë palë.

Palët Kontraktuese bien dakord që të lidhet një marrëveshje për sigurimet shoqërore.

Neni 19

Kjo Marrëveshje do t'i nënshtrohet ratifikimit ose miratimit në përputhje me procedurat e brendshme të secilës Palë Kontraktuese. Republika e Shqipërisë do të veprojë si Depozitar e kësaj Marrëveshjeje.

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së depozitimit të instrumenteve të ratifikimit nga të paktën dy Palë Kontraktuese dhe do të prodhojë efekt ligjor vetëm ndërmjet këtyre Palëve Kontraktuese.

Për një Palë Kontraktuese që ratifikon ose miraton këtë Marrëveshje pas hyrjes së saj në fuqi në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e 30 (të tridhjetë) pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit nga ajo Palë Kontraktuese.

Me kusht që kjo Marrëveshje të ketë hyrë në fuqi, zbatimi i saj do të fillojë në datën e hyrjes në fuqi të Marrëveshjes për ndërlidhjen e skemave për identifikimin elektronik të shtetasve të Ballkanit Perëndimor, të lidhur nga të njëjtat Palë Kontraktuese.

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me pëlqimin e ndërsjellë të të gjitha Palëve Kontraktuese.

Marrëveshja do të mbetet në fuqi për një kohë të pacaktuar.

Çdo Palë Kontraktuese mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje, duke e njoftuar depozitarin me shkrim, për synimin e saj për t'u tërhequr. Në një rast të tillë, Marrëveshja do të pushojë së qeni në fuqi për atë Palë Kontraktuese në ditën e 30 (tridhjetë) pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozitari.

Origjinali i kësaj Marrëveshjeje në një kopje të vetme në gjuhën angleze do të depozitohet te Depozitari, i cili do t'i dërgojë një kopje të vërtetuar secilës Palë Kontraktuese.

Bërë në Tiranë në datën njëzet e një dhjetor, dy mijë e njëzet e një.

Aleksandar Vučić
President i Republikës
së Serbisë

Edi Rama
Kryeministër i
Qeverisë së Republikës
së Shqipërisë

Zoran Zaev
President i Qeverisë së Republikës së
Maqedonisë e Veriut